



BROSHURË - ETIKA PROFESIONALE

SHKÇAK/SCAAK

KOMISIONI PËR SJELLJE DHE DISIPLINË

PRILL, 2021

Çfarë është etika?

Sjellje e cila përbëhet nga parimet, normat dhe standardet e praktikës së auditimit dhe kontabilitet, të cilat janë të pranueshme nga shoqëria.

Kush përcakton parimet e etikës?

Bordi Ndërkombëtar i Standardeve të Etikës për Auditor dhe Kontabilist (BSNEK/IESBA) përcakton parimet e etikës me cilësi të lartë, për auditor dhe kontabilist, të cilat janë të përshtatshme në nivel ndërkombëtare.

Kodi i Etikës i BSNEK-së përfaqëson parimet themelore të etikës për profesionistët kontabël, me tipar dallues pranimi i përgjegjësisë për të vepruar në interesin publik.

Parimet themelore të Kodit të Etikës për Auditor dhe Kontabilist janë:

- Integriteti
- Objektiviteti
- Kompetenca profesionale dhe kujdesi i duhur
- Konfidencialiteti
- Sjellja profesionale

Pse është e rëndësishme që Auditorët dhe Kontabilistët të veprojnë në përputhje me parimet e Kodit të Etikës?

- Ju konsideroheni profesionit
- Klienti apo Punëdhënësi juaj mbështet në shërbimin tuaj
- Ju keni çasje në informacione konfidenciale dhe të ndjeshme
- Minimizoni mundësinë e padive gjyqësorë ndaj jush

Çfarë nënkuptojnë parimet e Kodit të Etikës të BSNEK-së?

Integriteti – Të jesh i drejtpërdrejtë dhe i sinqertë në të gjitha marrëdhëniet profesionale.

Objektiviteti – Të mos lejosh që paragjykimi, konflikti i interesit ose ndikimi i panevojshëm i të tjerëve të ndikoj në gjykim tuaj profesional.

Kompetenca profesionale dhe kujdesi i duhur – Të mbash njohuritë dhe aftësitë profesionale dhe teknike në nivel të lartë, për të siguruar që klientit ose punëdhënësit jeni duke i ofruar shërbim profesional kompetent bazuar në zhvillimet më të fundit në standardet ndërkombëtare të profesionit dhe legjislacionit në fuqi.

Konfidencialiteti – Të respektosh konfidencialitetin e informacionit të marrë si rezultat i marrëdhënieve profesionale; të mos përdorësh informacionin konfidencial për avantazh personal të ose të palëve të treta; të mos zbulosh asnjë informacion të tillë për palët e treta pa autorizimin e duhur dhe specifik nëse nuk ka një të drejtë ose detyrë ligjore ose profesionale për t'u zbuluar.

Sjellja Profesionale – Të vepros në përputhje me ligjet dhe rregulloret përkatëse dhe të shmangësh çdo veprim që diskrediton profesionin.

Cilat janë kërcënimet kryesore ndaj respektimit të parimeve të Kodit të Etikës?

Kërcënimi i interesit personal – kërcënime të cilat mund të ndodhin si rezultat i interesave financiare ose interesave të tjerë të Auditorit apo Kontabilistit ose të një anëtarit të familjes së ngushtë të tij/saj.

Kërcënimi i vetë rishikimit – kërcënime të cilat mund të ndodhin kur një gjykim apo punë e mëparshme e Auditorit apo Kontabilistit rivlerësohet nga po ai Auditor apo Kontabilist.

Kërcënimi i avokim - kërcënime të cilat mund të ndodhin kur Auditori ose Kontabilisti promovon një pozicion ose opinion të tij/saj për një klient apo punëdhënës deri në atë pikë sa që objektiviteti i tij/saj mund të komprometohet.

Kërcënimi i familjaritetit – kërcënime të cilat mund të ndodhin kur, për shkak të një marrëdhënieje të gjatë apo të ngushtë me klientin apo punëdhënësin, Auditori apo Kontabilisti bëhet shumë dashamirës i interesave të tyre, apo shumë pranues i punës së klientit apo punëdhënësit.

Kërcënimi i frikësimit – kërcënime të cilat mund të ndodhin kur Auditori apo Kontabilisti mund të pengohen të veprojnë në mënyrë objektive për shkak të kërcënimeve aktuale ose të perceptuara, përfshirë përpjekjet për të ushtruar ndikim mbi Auditorin apo Kontabilistin.

Si duhet të veprojnë Auditorët dhe Kontabilistët për të respektuar parimet e Kodit të Etikës

Rezultatet në të cilat punojnë Auditorët dhe Kontabilistët mund të ndikojnë në shfaqjen e kërcënimeve specifike ndaj mosrespektimit të parimeve të Kodit të Etikës, si dhe mos veprimin në interes të publikut.

Kodi i Etikës i BSNEK-së shpalos tre hapa të cilët mundësojnë respektimin e parimeve dhe përmbushja e përgjegjësisë për të vepruar në interes të publikut:

1. Identifikimi i kërcënimeve
2. Vlerësimi i madhësisë së kërcënimit
3. Trajtimi i kërcënimit duke e eliminuar ose zvogëluar atë deri në nivel të pranueshëm

Si të mbrohemi nga këto kërcënime

Masat mbrojtëse janë veprime ose masa të tjera që mund të eliminojnë kërcënimet ose zvogëlojnë ato në një nivel të pranueshëm. Të tilla masa mbrojtëse janë si në vijim:

- Ndjekja e sesioneve të Edukimit të Vazhdueshëm Profesional (EVP)
- Respektimi i kërkesave të Standardeve Profesionale të punës
- Monitorimi i punës nga organet rregullatorë, organizata profesionale si dhe nga punëdhënësit.
- Përcaktimi i kohës së mjaftueshme dhe personelit të kualifikuar në kryerjen e detyrave.
- Rishikimi i punës nga një rishikues i cili nuk ka përgatitur ato dokumente.
- Shpalosja e informatave të cilat mund të kërcënojnë pavarësinë tek klienti apo punëdhënësi
- Marrja e informacioneve lidhur me një klient apo një çështje nga palët e treta
- Heqja dorë apo mos pranimi i një angazhimi apo punë kur kërcënimet nuk mund të zvogëlohen në një nivel të pranueshëm ashtu që nuk ndikon në pavarësinë tuaj në mendje dhe në dukje.